




Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup



RAPORT ANALITIK MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

RAPORT ANALITIK

MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

Botuesi:

Instituti për politikë evropiane – Shkup

Rreth botuesit:

Simonida Kacarska, PhD

Autor:

Vaska Bojaxhi

Dizajni grafik dhe printimi:

Relativ

Shkup, 2025



Ky dokument u përgatit në kuadër të Projektit “**Veprimi i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut**”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për politikë evropiane (EPI) - Shkup dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJE

SFONDI	4
GJETJET KRYESORE	5
1. MASAT E PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT	5
Ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.....	5
Politika dhe strategji gjithëpërfshirëse	6
Koordinimi	7
Monitorim i pavarur	8
2. TË DREJTAT DHE LIRITË CIVILE	11
Regjistrimi i lindjes.....	11
3. DHUNA NDAJ FËMIJËVE	13
Korniza strategjike kombëtare	13
Praktika të dëmshme	14
4. ARSIMI	15
Arsimi fillor	16
Arsimi i mesëm	18
Arsimi dhe trajnimi profesional	18
5. MASAT E MBROJTJES SË VEÇANTË.....	19
Luftimi i trafikimit.....	19
Drejtësi për fëmijët.....	21
KONKLuzion	22
LISTA E REFERENCAVE	23

SFONDI

Të drejtat e fëmijës janë një komponent thelbësor i detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të Maqedonisë së Veriut dhe po pozicionohen gjithnjë e më shumë si një pikë referimi për qeverisjen demokratike dhe reformat institucionale në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Si një vend kandidat, Maqedonia e Veriut pritet të sigurojë përputhje të plotë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KKDF) dhe Protokollet e saj Shtesë, si dhe të dëshmojë përparim të matshëm në këtë fushë në kuadër të Kapitullit 23—Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore të acquis të BE-së. Njëkohësisht, gjatë ciklit të katërt të Rishikimit Periodik Universal (RPU), vendi mori disa rekomandime të detajuara për forcimin e mbrojtjes ligjore, garantimin e zbatimit të saj dhe adresimin e mangësive sistematike në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Ky dokument shqyrton shkallën në të cilën vendi e ka përafruar kuadrin e të drejtave të fëmijëve me rekomandimet e RPU-së¹ dhe Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024,² me fokus të veçantë në përparimin e arritur në forcimin e kuadrit ligjor, politik dhe institucional. Analiza i kushton vëmendje të veçantë çështjeve të aksesit, barazisë dhe mbrojtjes - veçanërisht për fëmijët nga grupet e marginalizuara dhe të cenueshme - duke evidentuar fushat kryesore ku zbatimi mbetet i pjesshëm, i fragmentuar ose i vonuar.

Analiza ndjek grupet tematike të përcaktuara në udhëzimet e raportimit të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve,³ duke ofruar një vlerësim të strukturuar dhe krahasues. Çdo seksion fillon me një përmblidhje të rekomandimeve përkatëse nga RPU dhe Raporti i Progresit i BE-së, të cilat shërbejnë si pika referimi për vlerësimin e gjendjes aktuale të zbatimit. Fushat kryesore tematike të përfshira janë:

- » Masat e Përgjithshme të Zbatimit, duke u përqendruar në ratifikimin e instrumenteve ndërkombëtare, strategjitë kombëtare, mekanizmat e koordinimit dhe rolin e institucioneve të pavarura;
- » Të Drejtat dhe Liritë Civile, me theks në regjistrimin e lindjeve;
- » Dhuna ndaj fëmijëve, duke përfshirë kornizat strategjike, praktikat e dëmshme dhe mekanizmat e mbrojtjes institucionale;
- » Arsimi, që mbulon përfshirjen, heqjen e segregacionit, reformat ligjore dhe zhvillimin e arsimit dhe trajnimit profesional; dhe
- » Masa të Veçanta Mbrojtëse, që adresojnë trafikimin dhe drejtësinë për fëmijët.

Ky dokument synon të ofrojë si një përshkrim faktik ashtu edhe një analizë kritike të zhvillimeve kombëtare në këto fusha. Ai thekson progresin, identifikon sfidat strukturore dhe operacionale dhe propozon rekomandime praktike për të mbështetur një përafrim më të fortë me RPU-në dhe kërkesat e BE-së


1 RPU i Maqedonisë së Veriut (Cikli i 4-të - Sesioni i 46-të), lista tematike e rekomandimeve.

2 Komisioni Evropian. (2024). Raporti i Maqedonisë së Veriut 2024 North Macedonia 2024 report. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf (i aksesuar më: 31 Maj 2025).

3 Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (2015). Udhëzimet specifike të traktatit në lidhje me formën dhe përmbajtjen e raporteve periodike që do të dorëzohen nga Shtetet Palë sipas nenit 44, paragrafi 1 (b), të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (Treaty-specific guidelines regarding the form and content of periodic reports to be submitted by States parties under article 44, paragraph 1 (b), of the Convention on the Rights of the Child.) <https://docs.un.org/en/CRC/C/58/Rev.3> (i aksesuar: 31 Maj 2025).



GJETJET KRYESORE



1. MASAT E PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT

Ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Raporti i Progresit i KE-së

- » Maqedonia e Veriut të ratifikojë Konventën e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve të vitit 1996, Konventën e Hagës për Mbështetjen e Fëmijëve të vitit 2007 dhe Protokollin e saj mbi Ligjin e Zbatueshëm, të cilat janë nënshkruar tashmë.

Rekomandime të RPU-së

- » Të finalizohet ose përshpejtohet ratifikimi i Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi një Procedurë Komunikimi (Sllovakia, Togo, Ukraina, Paraguai).
- » Të ratifikohen instrumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që ende nuk janë miratuar, përfshirë Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, si dhe Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë (rekomandime nga Paraguai dhe Çekia)."

Konventa e Hagës e vitit 1996 për Mbrojtjen e Fëmijëve synon të sigurojë bashkëpunimin ndërkombëtar në mbrojtjen e fëmijëve përtej kufijve, veçanërisht në rastet që përfshijnë përgjegjësinë prindërore, kujdestarinë dhe vendosjen e fëmijëve. Megjithatë, ajo u nënshkrua në vitin 2019, por ende nuk është ratifikuar.⁴ *Po kështu, Konventa e Hagës e vitit 2007 për Mbështetjen e Fëmijëve dhe Protokollin e saj mbi Ligjin e Zbatueshëm*, të cilat përcaktojnë procedurat ndërkufitare për sigurimin e mbështetjes financiare për fëmijët, u nënshkruan gjithashtu në vitin 2019, por mbeten të paratifikuara.⁵

4 Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH). (2025). Tabela e statusit: Konventa e 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve. (Convention of 19 October 1996 on Jurisdiction, Applicable Law, Recognition, Enforcement and Co-operation in Respect of Parental Responsibility and Measures for the Protection of Children). (<https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=70> (e qasur më: 22 prill 2025)).

5 Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH). (2025). Tabela e statusit: Konventa e 23 nëntorit 2007 mbi Rimëkëmbjen Ndërkombëtare të Mbështetjes për Fëmijë dhe Formave të Tjera të Mbështetjes Familjare. (Convention of 23 November 2007 on the International Recovery of Child Support and Other Forms of Family Maintenance.) <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/status-table/?cid=131> (i aksesuar më: 22 prill 2025).

Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi një Procedurë Komunikimi (OPIC) u nënshkrua në vitin 2012; megjithatë, ai nuk është ratifikuar ende.⁶ OPIC u jep fëmijëve të drejtën për të paraqitur ankesa në Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës kur të drejtat e tyre janë shkelur dhe nuk ekziston asnjë mjet efektiv juridik në nivel kombëtar. Ai forcon llogaridhënien e shtetit dhe promovon aksesin në drejtësi duke inkurajuar reforma ligjore të ndjeshme ndaj fëmijëve dhe duke përforcuar statusin e fëmijëve si mbajtës të të drejtave.

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (ICRMW) përcakton mbrojtje gjithëpërfshirëse për punëtorët migrantë dhe familjet e tyre, duke përfshirë të drejtën për trajtim të barabartë, akses në drejtësi dhe mbrojtje kundër shfrytëzimit; megjithatë, ajo nuk është nënshkruar dhe as ratifikuar, pavarësisht rekomandimeve të përsëritura për ta bërë këtë.⁷

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë (ICPPED), e cila i detyron shtetet të parandalojnë, hetojnë dhe ndjekin penalisht zhdukjet me forcë dhe të garantojnë të drejtat e viktimave për të vërtetën dhe dëmshpërblimin, u nënshkrua në vitin 2007, por mbetet e paratifikuar.⁸

Politika dhe strategji gjithëpërfshirëse

Rekomandime të RPU-së

- » Të vazhdohet me zbatimin e strategjive kombëtare për të drejtat e njeriut për të mbrojtur grupet e cënueshme, duke përfshirë fëmijët, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara (Oman)

Një Plan Kombëtar Veprimi për të Drejtat e Fëmijëve (PKVD) u miratua fillimisht në vitin 2005 dhe u rishikua në vitin 2012.⁹ Megjithatë, nuk u caktuan fonde të dedikuara për zbatimin e tij dhe asnjë raport mbi zbatimin ose vlerësimin e tij nuk është bërë publik. PKVPAK ishte në fuqi deri në vitin 2015.

Në shtator të vitit 2023, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale njoftoi për fillimin e një Plani të ri Kombëtar Veprimi për të Drejtat e Fëmijëve, i cili do të zhvillohet në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit”, i financuar nga Bashkimi Evropian.¹⁰ Takimi fillestar përgatitor mblodhi përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Avokati i Popullit, Instituti për Çështje Sociale, UNICEF-i dhe Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë — Megjashi .

Në nëntor 2024, kanalet zyrtare të mediave sociale të projektit njoftuan se Drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2024–2028) iu prezantua Qeverisë gjatë një takimi plenar të Grupit Sektorial të Punës mbi arsimin, punësimin dhe politikat sociale.¹¹ Deri më tani, nuk ka informacion të disponueshëm nëse ekzistojnë plane për miratimin formal të Planit të ri të Veprimit.

6 Protokolli 11.d Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi një Procedurë Komunikimi United Nations Treaty Collection. (2025). 11.d Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on a Communications Procedure. https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtdsg_no=IV-11-d&chapter=4&clang=_en (Accessed: 22 April 2025).

7 Koleksioni i Traktateve të Kombeve të Bashkuara. (United Nations Treaty Collection.) (2025). Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre. (International Convention on the Protection of the Rights of All Migrant Workers and Members of Their Families.) https://treaties.un.org/pages/viewdetails.aspx?chapter=4&clang=_en&mtdsg_no=iv-13&src=treaty (i aksesuar më: 22 prill 2025).

8 Koleksioni i Traktateve të Kombeve të Bashkuara. (nd). Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë. (International Convention for the Protection of All Persons from Enforced Disappearance.) https://treaties.un.org/pages/viewdetails.aspx?chapter=4&clang=_en&mtdsg_no=iv-16&src=treaty (Accessed: 22 April 2025).

9 UNICEF (2013). Analiza e situatës së vajzave dhe djemve në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. (Analysis of the situation of girls and boys in the Former Yugoslav Republic of Macedonia.) <https://uni.cf/3jV4gib> (I aksesuar më: 30 mars 2025).

10 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (19 shtator 2023). Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve filloi [Preparation of the National Action Plan for Children's Rights has begun]. <https://shorturl.at/MgkI9> (E aksesuar më: 30 mars 2025).

11 LinkedIn, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit – Maqedonia e Veriut (inkedIn, EU Support for Rule of Law—North Macedonia) (2024, 22 nëntor). Draft plan kombëtar i veprimit për të drejtat e fëmijëve (PKV) 2024–2028! [Draft National Action Plan for Children's Rights (NAP) 2024–2028 presented!]. Gjetet në: <https://shorturl.at/RVkza> (I aksesuar më: 30 mars 2025).

Koordinimi

Raporti i progresit nga KE

- » Ende nuk është krijuar një organ kombëtar përgjegjës për koordinimin e të gjitha politikave që lidhen me zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe Protokolleve Opsionale (f. 38)

Ende nuk është themeluar një organ kombëtar përgjegjës për koordinimin e të gjitha politikave që lidhen me zbatimin e KDF dhe Protokolleve të saj Opsionale. Sipas njoftimit që shoqëron prezantimin e Draft Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2024–2028), një nga aktivitetet e propozuara përfshin krijimin e një Komisioni kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.¹² Ky Komision parashikohet si një mekanizëm për koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të garantuara nga KDF-ja e OKB-së. Megjithatë, nuk është dhënë asnjë informacion shtesë në lidhje me përbërjen, mandatin ose burimet e Komisionit që do të ndahen për të mbështetur punën e tij.

Kjo nuk do të ishte përpjekja e parë për të krijuar një mekanizëm të tillë. Një Komision Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës u formua fillimisht në vitin 2007.^{13,14} Pas disa vitesh pasiviteti, anëtarët e tij u shkarkuan zyrtarisht në vitin 2017, duke e shpërbërë organin në tërësi.¹⁵ Komisioni u krijua fillimisht si organi qendror koordinues dhe monitorues për zbatimin e KDF-së së OKB-së dhe politikave kombëtare për të drejtat e fëmijëve. Ai përbëhej nga përfaqësues nga ministri të ndryshme dhe agjenci qeveritare, Zyra e Avokatit të Popullit, zyra e UNICEF-it në vend dhe organizata të shoqërisë civile. Fillimisht i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë dhe më vonë nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale,¹⁶ Komisioni u përball me sfida të shumta, duke përfshirë një buxhet të pamjaftueshëm, ndryshime të shpeshta në anëtarësim dhe angazhim të kufizuar në planifikimin e politikave dhe përcaktimin e prioritetëve. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës shprehu shqetësim për mungesën e aktivitetit të Komisionit dhe mundësitë minimale që ai ofroi për pjesëmarrje nga qeveritë lokale, shoqëria civile dhe fëmijët.¹⁷

¹² Ibid.

¹³ Vendim për themelimin e Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Maqedonisë nr. 51-6893 / 1 nga 7 dhjetori 2010 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 126/2007).

¹⁴ Vendim për plotësimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Maqedonisë nr. 51-6893 / 1 nga 7 dhjetori 2010 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 164/2010).

¹⁵ Vendim për shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Maqedonisë nr. 24-3391 / 1 nga 11 korriku 2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/2017).

¹⁶ Vendim për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës në Republikën e Maqedonisë nr. 23-4892 / 1 nga 29 maji 2012 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 77/2012).

¹⁷ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Vërejtje Përfundimtare: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë CRC/C/MKD/CO/2 (2010).

Monitorim i pavarur

Raporti i progresit nga KE

- » Të ndahen burimet e nevojshme për Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të përmbushin mandatin e tyre (f. 7).

Rekomandime të RPU-së

- » Të sillen Zyra e Avokatit të Popullit në përputhje të plotë me Parimet e Parisit, duke përfshirë forcimin e pavarësisë, mandatin dhe promovimit të të drejtave të njeriut (Mali i Zi, Ukraina, Luksemburgu, Kosta Rika, Çekia).
- » Të sigurohen burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për Zyrën e Avokatit të Popullit për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj (Luksemburg, Kili, Kosta Rika, Çeki, Gjermani).
- » Të forcohet Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi duke adresuar pengesat ligjore dhe politike, me anë të sigurimit të përzgjedhjes së paanshme të personelit dhe duke ndarë fonde të mjaftueshme (Gjermani, Greqi).

Avokati i Popullit

Avokati i Popullit ka një mandat të gjerë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur këto të drejta shkelen nga organet e administratës shtetërore ose institucione të tjera me autoritet publik. Zyra qendrore është në Shkup, me zyra rajonale në Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

Me ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit në vitin 2009 u krijua zyrtarisht Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara (në tekstin e mëtejshëm "Departamenti") brenda zyrës qendrore.¹⁸ Përveç marrjes dhe hetimit të ankesave individuale që lidhen me shkeljet e dyshuara të të drejtave të fëmijëve, Departamenti gjithashtu ndërmerr kërkime tematike mbi çështjet kritike që prekin fëmijët. Raportet Vjetore të Avokatit të Popullit përfshijnë një seksion të dedikuar për të drejtat e fëmijëve, me të dhëna të detajuara mbi ankesat e pranura dhe përmbledhje të aktiviteteve të Departamentit. Gjetjet e kërkimit tematik publikohen gjithashtu si raporte të veçanta.

Zyrat rajonale luajnë një rol mbështetës në hetimin e ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Ankesat e pranura në nivel rajonal i përcillen Departamentit, i cili mund t'u delegojë detyra të caktuara zyrave rajonale, si mbledhje e dokumentacionit ose kërkim i informacionit nga institucionet përkatëse. Departamenti gjithashtu ushtron fuqinë statutoire të Avokatit të Popullit për të kërkuar mendime ekspertësh nga institucione shkencore ose profesionale ose ekspertë individualë gjatë hetimit të ankesave.

Që nga viti 2021, Departamenti drejtohet drejtpërdrejt nga Avokati i Popullit. Më parë, ai ishte nën mbikëqyrjen e Zëvendës Avokatit të Popullit.¹⁹ Sipas strukturës më të fundit organizative, Departamenti përbëhet nga gjashtë anëtarë të stafit, tre prej të cilëve punojnë ekskluzivisht në monitorimin dhe zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.^{20 21} Pjesa tjetër e stafit është përgjegjëse për çështjet që lidhen si me fëmijët ashtu edhe me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë të rriturit. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka ngritur vazhdimisht shqetësime në lidhje me burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare të Departamentit.²²

18 Neni 30, paragrafi 5, Ligji për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 60/2003, 114/2009, 181/2016, 189/2016 dhe 35/2018).

19 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (4 maj 2021). Rregullorja për organizimin dhe fushëveprimin e Punës së Shërbimit Ekspert, Ekipit të Mekanizmit Parandalues Kombëtar, Sektorëve të Posaçëm dhe Zyrave të Avokatit të Popullit. <https://shorturl.at/foHrB> (I aksesuar më: 30 March 2025).

20 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (5 prill 2022). Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin Ekspert, Ekipin e Mekanizmit Parandalues Kombëtar, Departamentet e Posaçme dhe Zyrat e Avokatit të Popullit. <https://shorturl.at/OFXuL> (I aksesuar: 30 mars 2025).

21 Këto përfshijnë: 1 Këshilltar Shtetëror për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara; 1 Këshilltar Shtetëror për Monitorimin dhe Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollit Opsional të Konventës; 1 Këshilltar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara; 2 Këshilltarë për Monitorimin dhe Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollit Opsional të Konventës; 1 Bashkëpunëtor i Ri për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara.

22 Komiteti për të Drejtat e Fëmijës. (2022). Vërejtje përfundimtare mbi raportet periodike të Maqedonisë së Veriut, të kombinuara nga raporti i tretë deri në të gjashtin. CRC/C/MKD/CO/3-6.

Megjithatë, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësim për vonesat në këtë proces.²³ Ndërsa komisioni parlamentar përgjegjës zakonisht e shqyrton Raportin Vjetor menjëherë, Kuvendi shpesh miraton masat përkatëse vetëm në fund të vitit. Kjo praktikë në fakt çënon detyrimin e Qeverisë për të raportuar dy herë në vit mbi veprimet e ndërmarra për të adresuar çështjet e raportuara nga Avokati i Popullit, shumë prej të cilave janë kritike për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Lidhur me pajtueshmërinë me Parimet e Parisit, Avokati i Popullit deklaroi në Raportin më të fundit Vjetor se nuk ishte bërë asnjë përparim drejt përmbushjes së kriterëve të kërkuara për marrjen e “statusit A” si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut - një detyrim kyç ndërkombëtar për të siguruar pavarësi të plotë.²⁴ Megjithatë, Avokati i Popullit është zotuar të arrijë pajtueshmëri të plotë me Parimet e Parisit deri në vitin 2027, në kuadër *Iniciativës 75 për të Drejtat e Njeriut 75 të OHCHR*.²⁵ Ndryshimet e reja legislative në Ligjin për Avokatin e Popullit kanë hyrë në procedurën parlamentare për të mbështetur këtë qëllim.²⁶

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) u krijua në vitin 2020 sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi,²⁷ duke zëvendësuar ish-Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas kuadrit ligjor të rishikuar, anëtarët e Komisionit emërohen si zyrtarë publikë që kryejnë detyrat e tyre profesionalisht dhe me kohë të plotë. Roli i tyre përjashton që ata të kenë një funksion tjetër publik, aktivitet profesional ose pozicion në një parti politike. Mandati i Komisionit është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme për të përfshirë promovimin dhe mbrojtjen e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit, si dhe parandalimin e diskriminimit. Ai gjithashtu drejton fushata ndërgjegjësimi publik, ofron edukim dhe informacion, jep opinione mbi programet dhe materialet edukative (si formale ashtu edhe joformale), publikon raporte tematike, propozon harmonizim ligjor, rekomandon ratifikimin e marrëveshjeve shumëpalëshe dhe dypalëshe dhe jep rekomandime të përgjithshme mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, ndërsa monitoron zbatimin e tyre. Për më tepër, Komisioni mund të iniciojë masa dhe veprime për të përmirësuar mbrojtjen nga diskriminimi.

Përveç tetë anëtarëve të emëruar, Komisioni ka një shërbim administrativ profesional. Megjithatë, Raporti Vjetor për vitin 2024 thekson se dy të tretat e pozicioneve në këtë shërbim mbeten të paplotësuara për shkak të mungesës së miratimit nga Ministria e Financave për punësime të reja.²⁸ Raporti thekson se mungesa e burimeve njerëzore dhe numri i lartë i pozicioneve të lira dëmtojnë seriozisht aftësinë e Komisionit për të vepruar në mënyrë efikase, për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur mandatin e tij ligjor. Forcimi i burimeve institucionale dhe njerëzore të Komisionit dhe krijimi i një shërbimi administrativ profesional dhe të pavarur mbetet një sfidë kryesore në vitin 2025.

Lidhur me rastet e diskriminimit që përfshijnë fëmijë, Komisioni pranon ankesa të paraqitura drejtpërdrejt nga fëmijët ose në emër të tyre nga persona të tjerë, siç janë prindërit, kujdestarët ligjorë (duke përfshirë rastet me fëmijë me aftësi të kufizuara), avokatët, organizatat e shoqërisë civile ose fondacionet - me

23 Bojarovski, Z. (2025, 2 shkurt). Ziberi : Qeveria nuk ka paraqitur asnjëherë raport për mënyrën e zbatimit të masave të miratuara në bazë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit (Зибери: Владата никогаш не поднела извештај како ги спроведува мерките донесени по препораките на Народниот правобранител [Ziberi]. Racin.mk. <https://racin.mk/intervju/ziberi-vladata-nikogash-ne-podnela-izveshtaj-kako-gi-sproveduva-merkite-doneseni-po-preporakite-na-narodniot-pravobranitel/> (I aksesuar më: 30 mars 2025).

24 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2025). Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut: 2024. <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2024/GI-2024.pdf> (I aksesuar më: 20 prill 2025).

25 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2023). Zotim i paraqitur nga Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut drejtuar Sekretariatit të të Drejtave të Njeriut 75.<https://shorturl.at/Y9YoO> (I aksesuar më: 30 mars 2025).

26 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Projektligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas një procedure të shkurtuar. <https://shorturl.at/Amair> (I aksesuar më: 30 Mars 2025).

27 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 258/2020).

28 Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. (2025). Raporti vjetor për vitin 2024. <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2025/04/Годишен-извештај-2024-КСЗД.pdf> (I aksesuar më: 30 mars 2025).

kusht që të jepet pëlqimi paraprak.²⁹ Organizatat e shoqërisë civile dhe fondacionet me një interes legjitim në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mund të paraqesin ankesa nëse mund të demonstrojnë në mënyrë të arsyeshme se një grup fëmijësh i është nënshtruar trajtimit diskriminues nga një individ ose entitet juridik.

Raportet vjetore të Komisionit përfshijnë të dhëna demografike mbi ankuesit, me grupmosha që përfshijnë 1–10 dhe 11–20 vjeç. Megjithatë, nuk është e qartë se sa ankesa janë paraqitur nga fëmijë nën 18 vjeç dhe nuk ofrohen të dhëna se sa ankesa lidhen konkretisht me fëmijët, pavarësisht nëse janë paraqitur nga një fëmijë, një i rritur apo një organizatë.

Megjithatë, duhet theksuar se Komisioni identifikon dhe reagon në mënyrë aktive ndaj rasteve të mundshme dhe aktuale të diskriminimit ndaj fëmijëve, bazuar në ankesat e paraqitura, si dhe me iniciativën e vet. Për shembull, dy raste ex officio të iniciuara vitin e kaluar kishin të bënin me mbrojtjen e fëmijëve: njëra lidhej me vonesën në sigurimin e asistentëve arsimorë dhe tjetra me ndarjen e nxënësve romë në shkolla.

Për më tepër, Komisioni jep rregullisht mendime ekspertësh mbi projektligjet përkatëse për antidiskriminim, duke përfshirë ligjet që prekin fëmijët. Në vitin 2024, për shembull, ai paraqiti komentet dhe rekomandimet e tij specifike mbi projektligjet për arsimin fillor dhe të mesëm.³⁰

29 Ibid.

30 Ibid.

2. TË DREJTAT DHE LIRITË CIVILE



Regjistrimi i lindjes

Rekomandime të RPU-së

- » Të sigurohet që të gjitha lindjet të regjistrohen menjëherë, pavarësisht nga statusi i imigracionit të prindërve, dhe kështu të zvogëlohet pashtetësia (Kosta Rika)
- » Të forcohen mekanizmat për të lehtësuar regjistrimin e lindjeve të të gjithëve, përfshirë ata që i përkasin komunitetit rom, migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve, në mënyrë që këta të gëzojnë të drejtat e tyre, veçanërisht të drejtën për shëndetësi, mbrojtje sociale dhe arsim (Filipine)

Mungesa e një zgjidhjeje sistemike për regjistrimin e fëmijëve, prindërit e të cilëve nuk posedojnë dokumente identifikimi personal, ka qenë një problem i hershëm në vend.

Në vitin 2020, u miratua Ligji për Personat e Paregjistruar në Regjistrin e Lindjeve për të adresuar këtë boshllëk.³¹ Ai synonte të regjistronte rreth 700 individë, të identifikuar përmes një thirrjeje publike të vitit 2018 - megjithëse nuk ishte e qartë se sa prej tyre ishin fëmijë - duke krijuar një regjistër të posaçëm lindjesh.³² Individët e regjistruar do të merrnin dokumente identifikimi të përkohshme dhe do të fitonin qasje në katër të drejta themelore: kujdes shëndetësor, arsim, mbrojtje sociale dhe punësim me sigurim të detyrueshëm, derisa identiteti i tyre të përcaktohej zyrtarisht.

³¹ Ligji për Personat e Paregjistruar në Regjistrin e Lindjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 42/20, datë 15 shkurt 2020).

³² Projektligj për Personat e Paregjistruar në Regjistrin e Lindjeve. Nëntor 2019. <https://bit.ly/36qTZWv> (I aksesuar më: 16 April 2025).

Pavarësisht qëllimeve të mira, ligji dështoi në arritjen e objektivave të tij. Avokati i Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile vazhdimisht kanë ngritur shqetësime se individëve të prekur nuk u janë dhënë të drejtat themelore dhe as nuk janë regjistruar në regjistrin e rregullt të lindjeve.³³

Në përgjigje të kësaj, në qershor 2023 u miratuan ndryshimet në Ligjin për Regjistrin Civil.³⁴ Këto ndryshime kërkonin që të gjithë individët e identifikuar të regjistroheshin në regjistrin e rregullt të lindjeve deri më 31 dhjetor 2023. Ndryshimet gjithashtu lejojnë që fëmijët të regjistrohen përmes një deklarate të noterizuar nga dy dëshmitarë nëse prindërit nuk kanë dokument identifikimi, dhe fuqizojnë Qendrat e Punës Sociale për t'i caktuar një emër fëmijës kur është e nevojshme. Një përparim i madh erdhi me futjen e Nenit 4a, i cili urdhëron që çdo fëmijë i lindur në vend duhet të regjistrohet brenda 45 ditëve nga lindja, pavarësisht nga shtetësia ose statusi ligjor i prindërve. Zbatimi i vazhdueshëm i kësaj dispozite shihet si çelësi për parandalimin e rasteve të ardhshme të fëmijëve të paregjistruar.

Megjithatë, raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2025 nxjerr në pah sfidat e vazhdueshme.³⁵ Bazuar në të dhënat nga Drejtoria për Regjistrat Civilë, që nga shtatori 2024, Qendrat për Punë Sociale kishin paraqitur 441 kërkesa për regjistrim për fëmijë të lindur në institucione mjekësore, por të paregjistruar brenda afatit ligjor. Vetëm 59 raste ishin përfunduar, ndërsa shumica mbetën në pritje, të paplota ose të ndërprera. Pengesat më të zakonshme përfshijnë: mosparaqitjen e prindërve për regjistrim, mungesën e vendimeve të emërimit nga Qendrat e Punës Sociale, përgjigje në pritje për statusin e shtetësisë prindërore dhe mungesën e dokumentacionit. Këto probleme vazhdojnë pavarësisht bashkëpunimit të Drejtorisë me shoqërinë civile për të identifikuar dhe regjistruar fëmijët e paregjistruar.

Avokati i Popullit arriti në përfundimin se, pavarësisht ndryshimeve ligjore, autoritetet vazhdojnë të përbalen me pengesa në regjistrimin e fëmijëve dhe ka rekomanduar zbatimin e plotë të dispozitës ligjore që kërkon regjistrimin e çdo fëmije të lindur në vend, pavarësisht shtetësisë ose statusit ligjor të prindërve.

33 P.sh., Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas (2021). Raporti Vjetor 2021. <https://rb.gy/or0fqf> (I aksesuar më: 30 maj 2025); Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2022). Raport i veçantë nga hulumtimi më i fundit mbi gjendjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Pashënuar në Regjistrin Civil të Lindjeve (Посебен извештај од последното истражување за согледување на состојбата со имплементација на Законот за неевидентирани лица во матична книга на родени <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Posebni%20izvestai/2022/Posebni%20izvestaj-Neevidentirani%20lica-2022.pdf> (I aksesuar më: 30 Maj 2025).

34 Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Regjistrin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 129/2023).

35 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024). Raporti Vjetor mbi Promovimin, Mbrojtjen dhe Avancimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Shkup: Institucioni i Avokatit të Popullit. <https://shorturl.at/yMW5> (I aksesuar më: 16 Prill 2025).

3. DHUNA NDAJ FËMIJËVE



Korniza strategjike kombëtare

Raporti i progresit nga KE

- » Nevojitet më shumë mbështetje për mekanizmat për të luftuar dhunën dhe fonde të mjaftueshme për strategjinë kombëtare për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve (2020-2025) (f. 38).
- » Të ofrohet mbështetje e përshtatshme për kategoritë e fëmijëve në nevojë, veçanërisht fëmijët viktimë të dhunës, fëmijët romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (f. 7).

Rekomandime të RPU-së

- » Të shtohen përpjekjet për të zbatuar planin kombëtar të veprimit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca, duke siguruar burime të mjaftueshme financiare për zbatimin e tij (Armenia, Gjeorgjia).
- » Të forcohen masat për të luftuar dhunën nga bashkëmoshatarët, ngacmimin online dhe dhunën ndaj fëmijëve, duke përfshirë politikat publike, fushatat e ndërgjegjësimit dhe aktivitete të tjera të synuara (Brazil, Izrael).

Strategjia Kombëtare (2020–2025) dhe Plani i Veprimit (2020–2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna u miratuan në dhjetor 2019.³⁶ Strategjia përshkruan një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj fëmijëve, duke synuar krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës përmes zhvillimit të një sistemi kombëtar të forcuar për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes së fëmijëve. Qëllimi i saj i përgjithshëm është të parandalojë të gjitha format e dhunës dhe përvojat e tjera të pafavorshme të fëmijërisë duke promovuar bashkëpunimin ndërsektorial dhe duke përmirësuar përgjigjet institucionale. Strategjia identifikon gjashtë fusha strategjike: kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar për parandalim dhe mbrojtje; avancimin e njohurive, praktikës dhe vlerave që promovojnë tolerancë zero ndaj dhunës; zbatimin e programeve parandaluese dhe forcimin e qëndrueshmërisë së familjes; rritjen e kapaciteteve institucionale për mbrojtje, trajtim dhe mbështetje të fëmijëve; mbrojtjen e fëmijëve brenda sistemit të drejtësisë për të mitur; dhe krijimin e sistemeve për mbledhjen e të dhënave, provave dhe monitorimin në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve.

Plani i Veprimit përfshin një sërë masash të përafuara me secilën prej këtyre fushave strategjike dhe përcakton afatet kohore dhe përgjegjësitë për zbatim. Ai gjithashtu parashikon monitorimin e zbatimit nga Organi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhenca (NCBPCAN), i cili pritet të publikojë raporte vjetore dhe trevjeçare. Përveç kësaj, dokumenti parashikon kryerjen e një vlerësimi dhe auditimi të aktiviteteve të zbatuara deri në vitin 2022, si dhe zhvillimin dhe miratimin e një Plani të ri Veprimi për periudhën 2023–2025 deri në fund të vitit 2022.

³⁶ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (2019). Strategjia Kombëtare (2020–2025) dhe Plani i Veprimit (2020–2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna . <https://rb.gy/cme0sw> (I aksesuar më: 30 Maj 2025).

Megjithatë, deri më sot nuk janë publikuar raporte mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Nuk ka asnjë raport vlerësimi të disponueshëm, dhe as nuk është bërë publik ndonjë Plan Veprimi i përditësuar. Gjithashtu, është e paqartë nëse NCBPCAN ka mbetur aktiv dhe ka vazhduar të monitorojë zbatimin. Raporti i fundit nga ky organ daton që nga viti 2019 dhe përmban **të dhëna mbi dhunën ndaj fëmijëve të mbledhura në vitin 2017.**³⁷

Organi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhenca u krijua fillimisht me vendim qeverie në vitin 2012 dhe u rivendos në vitin 2017. Ai kryesohet nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Praktika të dëmshme

Rekomandime të RPU-së

» Të ndalohet martesë e fëmijëve në të gjitha rrethanat (Islanda).

Sipas Kodit Penal, martesë e fëmijëve është e ndaluar dhe bashkëjetesa në një bashkësi jashtëmartesore me ose midis të miturve është kriminalizuar.³⁸ Ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2018 rritën prapën moshën për sanksionimin e bashkëjetesës jashtëmartesore me një të mitur nga 16 në 18 vjeç.³⁹

Ligji për Familjen përcakton që një fëmijë nën moshën 18 vjeç nuk mund të lidhë martesë.⁴⁰ Megjithatë, ai parashikon një përjashtim, sipas të cilit një gjykatë mund të lejojë një fëmijë që ka mbushur moshën 16 vjeç të martohet. Kjo leje i nënshtrohet kushtit që një mendim paraprak mjekësor nga një institucion shëndetësor të vërtetojë aftësinë fizike dhe mendore të nevojshme për të përmbushur të drejtat dhe detyrat e jetës martesore.⁴¹

Në përputhje me rekomandimin e Islandës sipas RPU-së, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, në vëzhgimet e tij **më të fundit, ka rekomanduar që Ligji për Familjen të ndryshohet për të hequr të gjitha përjashtimet që lejojnë martesën nën moshën 18 vjeç.**⁴²

Pavarësisht ndalimeve ekzistuese ligjore, martesat e hershme dhe bashkëjetesa jashtëmartesore që në moshë të re mbeten probleme të vazhdueshme, veçanërisht brenda komunitetit rom. Sipas të dhënave të MICS, në vendbanimet romë, 45.1% e grave të moshës 20 deri në 24 vjeç janë martuar para moshës 18 vjeç, krahasuar me 7.5% në popullsinë e përgjithshme.⁴³ Mungesa e protokolleve operative, vëmendja e pamjaftueshme publike ndaj kësaj çështjeje dhe pranimi i saj si pjesë e praktikave tradicionale brenda komuniteteve të caktuara janë ndër pengesat kryesore për adresimin e saj.⁴⁴

Gjithashtu, ka mungesë të të dhënave mbi fëmijët refugjatë dhe migrantë që preken nga ose janë në rrezik në rritje të praktikave tradicionale të dëmshme, si dhe mungesë të masave të përshtatshme parandaluese.

37 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (2019). Raport mbi situatën në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhimi kundër treguesve të krijuar për vitin 2017.

38 Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut") No. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017, 248/2018, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut No. 35/2023).

